



**REPUBLIKA E SHQIPERISË**  
**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË**  
**SENATI AKADEMIK**

---

Nr. .... Prot.

Vlorë, më 31.10.2016

**Vendim**  
**Nr. 53, datë 31.10.2016**

**PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË DHËNIES SË TITULLIT "DOCTOR  
HONORIS CAUSA" AKADEMIK JORGAQ KACANIT**

Mbështetur në kreun II, pika 2.6 të VKM, nr. 467, datë 18.07.2007 "Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për kualifikimin shkencor dhe pedagogjik të personelit akademik", i ndryshuar me VKM, nr. 91, datë 10.02.2010, si dhe në propozimin e Departamentit të Inxhinierisë dhe Teknologjisë Detare për dhënien e titullit "Doctor Honoris Causa" akademik Jorgaq Kaçanit, nr. 612 prot., datë 26.10.2016, Senati Akademik në mbledhjen e datës 31.10.2016

**VENDOSI:**

1. Të miratojë hapjen e procedurës për dhënien e titullit "Doctor Honoris Causa" akademik Jorgaq Kaçanit.
2. Të miratojë si relatorë Prof. Bilal Shkurtaj dhe Prof. As. Kristofor Lapa.
3. Vendimi protokollohet dhe bëhen njoftimet përkatëse.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**  
**Prof. Dr. Roland ZISI**

Ky dokument përpilohet në 3 (tri) kopje.